



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>3182</u>	Nr. i faqj / Br. str / No. pg <u>4</u>	
Data / Datum / Date: <u>27.11.2018</u>		Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Adresa, Rruga e UÇK-së, 30000, Pejë - Republika e Kosovës, Nr. Tel +381 039 432 270, info@unhz.eu

RREGULLORE PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE NË PUNË PRAKTIKE NË ADMINISTRATËN E UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË

PEJË 2018

Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në bazë të nenit 17, 22, të Statutit të Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2018 miratoi:

Këshilli Drejtues i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, në bazë të nenit 17, 22, të Statutit të Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2018 miratoi:

RREGULLORE PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE NË PUNË PRAKTIKE NË ADMINISTRATËN E UNIVERSITETIT “HAXHI ZEKA” NË PEJË

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është promovimi, aftësimi dhe avancimi profesional i studentëve dhe të posa diplomuarve, bazuar në nevojat e tregut të punës në fushat që lidhen me departamentet dhe njësisë akademike në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon formën e angazhimit të studentëve në punë praktike në Administratën e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Neni 3 Kohëzgjatja e punës praktike

Punën praktike studentët e kryejnë në Administratën e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe zgjat deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 4 Kriteret për përzgjedhjen e studenteve për punë praktike

1. Përzgjedhja e studentëve do të bëhet nëpërmes konkursit publik që shpallet nga zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në faqen e UHZ – së, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregullore.
2. Vlerësimin e dosjeve të kandidatëve të cilët paraqiten në konkurs do të bëjë komisioni profesional i themeluar nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike do të merret parasysh nota mesatare gjatë studimeve bachelor apo master.
4. Studentët që përzgjidhen për të kryer punë praktike duhet të jenë në vitin e fundit të studimeve (apsolvent) bachelor ose të jenë te regjistruar në studimet master, ata që kanë diplomuar gjashtë muajt e fundit.

5. Në kushte të barabarta përparësi pranimi kanë studentët të cilët janë duke studiuar apo kanë studiuar në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 5

Periudha e angazhimit, numri dhe sistemimi

1. Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në bazë të konkursit publik do të angazhoj në punë praktike deri në 20 studentë në vit kalendarik.
2. Sistemimi i praktikantëve bëhet nga Departamenti i Administratës në koordinim më Sekretarin e Përgjithshëm.
3. Praktikantët do të sistemohen në mënyre proporcionale në të gjitha departamentet e Administratës së Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 6

Rregullimi i punës praktike

1. Studentët e përzgjedhur për punë praktike duhet të nënshkruajnë deklaratën e etikës si dhe kontratën e angazhimit më Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre.
2. Periudha e angazhimit në punë praktike zgjat gjashtë (6) muaj dhe është më pagesë, sipas mundësive buxhetore të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
3. Në fund të periudhës së angazhimit, Universiteti bënë vlerësimin e punës së praktikantëve sipas rekomandimeve të udhëheqësve të departamenteve ku janë angazhuar praktikantët dhe bazuar në këtë vlerësim, lëshon certifikatë për punën praktike të kryer nga studentët.
4. Praktikantet e angazhuar ju nënshtrohen Statutit, Rregulloreve dhe të gjitha akteve të nxjerra nga Universiteti.
5. Në rast të veprimeve që bien në kundërshtim më paragrafin 4 të këtij neni, Universiteti rezervon të drejtën për shkëputjen e kontratës.

Neni 7

Dispozita kalimtare

Praktikantët të cilët janë të angazhuar në praktik në momentin e miratimit të kësaj Rregullore mbesin në proces deri në përfundimin e periudhës 6 mujore.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Këshillit Drejtues

Nur Çeku
